

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Masa e sigurisë për Vlora Hysenin/ Rama e liron nga detyra si kryetare e SHISH
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/masa-e-sigurise-per-vlora-hysenin-rama-e-liron-nga-detyra-si-kryetare-i474902
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:05:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 13:31:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a1b469d3748ebdcbc3b5f02cffe07a83073ae6d0765587d7ef190b79bfe47c3
TEKSTI	5312444cafc74862702db32b2e176dd361c7a14798e192ce3ad343354723819a
PAMJA	f3e9ae4f3b3c4e19e2d65c0475b91c3eb918a03e8793fd4bb44a14bda339c261

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0915197073b777a47e5c30406ef2af86ac0b5d83691ad1b38b22050e3853e637
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0915197073b777a47e5c30406ef2af86ac0b5d83691ad1b38b22050e3853e637>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)




English
English

Masa e sigurisë për Vlora Hysenin/ Rama e liron nga detyra si kryetare e SHISH



22 Shtator 2026, 15:31, Aktualitet CNA



Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas caktimit të masës së sigurisë me urdhër të SPAK-ut për Vlora Hysenin, ku ka njoftuar lirin e saj nga detyra si drejtoreshë e Shërbimit Informativ të Shtetit.

Në postimin e tij në platformën "X", Rama shkruan se pret që çdo dyshim i organit të akuzës të hetohet dhe zbardhet deri në fund përmes procesit të pavarur gjyqësor.

Ai shprehet se përtej respektit për punën e saj dhe Hysenit si person rruga e zgjedhur nga kjo qeverisje është ajo "e pavarësisë së organeve të drejtësisë për të hetuar e gjykuar këdoqoftë, pavarësisht statusit social apo funksionit publik".

Kreu i qeverisë shprehet më tej se çdokush është i pafajshëm deri në gjykimin përfundimtar, siç askush nuk është mbi ligjin për asnjë arsye.

Ndërsa njofton lirin e Hysenit nga detyra, Rama njofton se sapo të kthehet nga SHBA-ja në Tiranë, në konsultim me Presidentin e Republikës, do të zgjidhet drejtuesi i ri të Shërbimit Informativ të Shtetit.

Reagimi i plotë:

Për shkak të orareve të ndryshme ky reagim nga Nju Jorku, ku jam për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, mund të duket i vonuar dhe ndjesë për këtë.

Jam informuar lidhur me masën e arrestit shtëpiak që SPAK-u ka nxjerrë për drejtoren e Shërbimit Informativ të Shtetit, e pres që çdo dyshim i organit të akuzës të hetohet dhe zbardhet deri në fund përmes procesit të pavarur gjyqësor.

Përtej respektit për punën dhe për personin e Vlora Hysenit, si edhe po ashtu përtej vlerësimeve të vazhdueshme, që ajo ka marrë nga agjencitë partnere si drejtuese e shërbimit inteligjent shqiptar, rruga pa kthim që kemi zgjedhur është rruga e pavarësisë së organeve të drejtësisë për të hetuar e gjykuar këdoqoftë, pavarësisht statusit social apo funksionit publik.

Por po ashtu, është e pashmangshme mesa duket, që çdo hetim apo masë e marrë nga drejtësia në adresë të personave publikë, të kthehet në një motivim për të grirë mish njeriu në mexhelisin politik e mediatik dhe për të thirrur "litarin" si në sheshet e ekzekutimit mesjetar, kohë përpara sesa gjykata të thotë fjalën e saj.

E megjithatë, kurrësi nuk mund të jetë e vërtetë që veprimet e pavarura të drejtësisë dhe afirmimi i vijueshëm i barazisë para ligjit, të jenë njëkohësisht akt-akuza kundër pikërisht një shumice qeverisëse e cila me kurajo e me vendosmëri, ia ka çelur rrugën drejtësisë së pavarur, në një vend ku deri para shumë pak vitesh kjo pavarësi ishte e paimagjinueshme prej shekujsh.


As mund të jenë këto zhvillime me drejtësinë baltë kundër Shqipërisë, e cila po bën në rrugën e saj të bashkimit me Europën shumëçka që as nuk mund të imagjinohet akoma në vendet e tjera të rajonit dhe që koha do ta çmojë më mirë se sa kushdo.

Çdokush është i pafajshëm deri në gjykimin përfundimtar po askush nuk është mbi ligjin në asnjë rast e për asnjë arsye, kështu që unë i jam falenderues Vlora Hysenit për çdo gjë që ka bërë si duhet në shërbim të Shqipërisë, ndërsa për gjithçka tjetër që ka të bëjë me çështjen e sapohapur nga organet e drejtësisë, qëndrimi im mbetet po ai i ditës së parë të Reformës në Drejtësi:

Pafajësia ose fajësia e një bashkëpunëtori të vendosur nën akuzë është një çështje individuale përballë prokurorisë e gjykatës dhe kjo shumicë qeverisëse me mua në krye, i mbetet besnike këtij qëndrimi duke mos hyrë në meritën e asnjë çështjeje të drejtësisë dhe duke mos bërë avokatinë e askujt që përballlet me drejtësinë.

Lirimi nga detyra i drejtores së shërbimit është i menjëhershëm, e sapo të kthehem në Tiranë dhe në konsultim me Presidentin e Republikës, do të zgjedhim drejtuesin e ri të Shërbimit Informativ të Shtetit. /CNA

- **Vlora Hyseni dhe Ilir Proda në rrjetën e SPAK-ut/ Prokuroria e Posaçme jep detaje**
- **Vlora Hyseni drekonte e darkonte me Agasin në mes të Tiranës**
- **Prapaskenat/ Vlora Hyseni, nga shkarkimi tek Inteligjenca e Kosovës, te ardhja në krye të SHISH-it**
- **Kush është Vlora Hyseni, si u emërua në krye të SHISH-it dhe çfarë deklaronte asokohe Rama**
- **Goditja e SPAK-ut ndaj Vlora Hysenit dhe Ilir Prodës/ Kaso: Është certifikuar rënia e shtetit**
- **Iu vendos masa e sigurisë arrest shtëpie/ Zbulohet vendndodhja e drejtoreshës së SHISH**
- **Çfarë ishte Ergys Agasi që drejtoresha e SHISH dhe ish-kreu i Policisë i shkonin në zyrë?**
- **EKSKLUZIVE/ Si ranë në rrjetën e SPAK-ut Vlora Hyseni dhe Ilir Proda**
- **Shkundet SHISH/ Drejtoresha i dërgonte informacione shtetërore Ergys Agasit**
- **Aksioni i SPAK-ut/ Zbulohen detaje nga kontrollet në banesën e Ilir Prodës dhe për masën ndaj Vlora Hysenit**
- **Tronditet SHISH, drejtoresha në arrest shtëpie**





Të sugjeruara

Gjobëvënia nga mediat dhe portalet anonime/ Nikolin Jaka: Po sulmohen dhe dëmtohen qelli bizneset

Projektligji i ri krijon hapësirën e posaçme ligjore për emetimin e obligacioneve të mbuluara

Kikia: Ngjarje fatale, zyrtarët e inkriminuar kanë ngrënë kokën e shtetit

Masa ndaj Hysenit/ Xhafaj, si Spiropali: Ndodh rëndom në botë

Operacioni i SPAK-ut/ Kontrolle në kompleksin e vilave në Shkozë

Vlora Hyseni dhe Ilir Proda në rrjetën e SPAK-ut/ Prokuroria e Posaçme jep detaje

Apeli i Posaçëm lë në burg Ergys Agasin dhe ish-efektivin që e shoqëronte

“Rama e Agasi takoheshin në Durrës”/ Kush është Embro Sulejmani?

Vlora Hyseni drekonte e darkonte me Agasin në mes të Tiranës

Prapaskenat/ Vlora Hyseni, nga shkarkimi tek Inteligjenca e Kosovës, te ardhja në krye të SHISH-it

Opozita "bllokoni" Komisionin/ Përplasje pas aksioneve të SPAK-ut

Berisha, thirrje FBI-së: Nëse Vlora Hyseni është me Ramën arrestojeni

Masa ndaj Vlora Hysenit/ Berisha: Shefja e SHISH në shërbim të krimit, nivel i ulët tradhtie

Kush është Vlora Hyseni, si u emërua në krye të SHISH-it dhe çfarë deklaronte asokohe Rama

Vlora Hyseni dhe Ilir Proda në rrjetën e SPAK-ut/ Flamur Noka: Kartelet e drogës komandojnë shtetin

Aksioni i SPAK-ut/ Pse u arrestuan shefi i policisë dhe biznesmeni

Goditja e SPAK-ut ndaj Vlora Hysenit dhe Ilir Prodës/ Kaso: Është certifikuar rënia e shtetit

Iu vendos masa e sigurisë arrest shtëpie/ Zbulohet vendndodhja e drejtoreshës së SHISH

Bordi i Transparencës vendos çmimet e reja/ Ja sa do të tregtohen nafta dhe benzina


Masa për Hysenin dhe kontrollet për Prodën/ Tabaku: Të thirret Këshilli i Sigurisë Kombëtare

[editorial](#)

16:30 Editorial

Agasi, Veliaj, Proda, Hyseni; Harta e një shteti që po shpërbëhet

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.